

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**DuaSol Green Albania**

NENI 1  
FORMIMI

**Sot me date 01.12.2024** themeluesit qe firmosin me poshte:

**Z. Xhulio Mata** shtetas shqiptar me zotesi te plote per te vepruar, i lindur ne Ura Vajgurore, me 09 Prill 1992, mbajtes i leternjoftimit me nr personal J20409075T;

Ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 „Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare „ si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit “ themeloj me vullnet te lire shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar ,me emertim **DuaSol Green Albania**.

NENI 2  
SELIA

Selia e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **DuaSol Green Albania** eshte ne Rrugen “Myslym Shyri”, Pallati 43, Shkalla 1, Ap. 3, Tirane. Shoqeria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin.

NENI 3  
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **DuaSol Green Albania** eshte pa afat nga momenti i regjistrimit te saj prane QKB Tirane.

NENI 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise **DuaSol Green Albania** eshte:

- Aktivitet tregtare ne fushen e turizmit kulturor dhe ne fushen e hotelerise
- Sherbime ne promovimin e aktiviteteve turistike
- Organizim evente sociale dhe kulturore
- Sherbime te akomodimit turistik
- Agjensi turistike, organizimi i udhetimeve turistike, biznese, turne, pushime, sherbime per udhetime tokesore, ajrore e detare. Rezervime dhe pergatitje biletash. Sherbime dhe pronotime hotelesh brenda dhe jashte vendit.
- Makina me qera
- Promovimi dhe punesimi i te rinjve
- Prodhime artizanale, tregetim me pakice dhe shumice i suvenireve
- Sherbim informacioni dhe guida per turistet

NENI 5  
KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë **DuaSol Green Albania** është **100,000 leke** dhe i ndare ne 1 kuote me kontributin e ortakeve si me poshtë:

1. Një kuote **Z. Xhulio Mata** ne masën 100 % (njqind perqind) te kapitalit themeltar.



Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku themelues, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortaku, por asnjëherë nuk mund të pakësohet në nivelin e kapitalit themeltar.

#### NENI 6 ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese të shoqërisë **DuaSol Green Albania** janë:

- Asambleja e Ortakeve ,organi më i lartë vendim marrës
- Administrator është **Z. Xhulio Mata**, nr personal J20409075T. Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet, **deri 01.12.2029**

#### NENI 7

Organizimi i shoqërisë ,mardheniet me persona fizikë e juridikë ,vendos apo të huaj ,shprehen në status që bashkë me aktin themelimit janë dokumentat baze të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e mardhenieve në këtë shoqëri

#### NENI 8

Veprimtarinë saj ,shoqëria do të zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar

#### NENI 9

Të gjitha mosmarrveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim , me anë të dispozitave të këtij akti ,statuti edhe legjislacionin shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me gjykatë

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e rregjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **DuaSol Green Albania** në QKB në këtë ditë shoqëria **DuaSol Green Albania** njihet si person juridik

### ORTAKU I VETEM I SHOQERISE **DuaSol Green Albania**

**Z. Xhulio Mata**

Xhulio MATA  


**Ne përputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument përben:**

## **STATUTI**

**i**

**Shoqërisë me Përgjegjësi te Kufizuar**

**DuaSol Green Albania**



**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**DuaSol Green Albania**

NENI 1  
FORMIMI

Sot me 01.12.2024 ne Tirane, ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” hartohet ky statut per rregullimin normativ te funksionimit te shoqerise tregetare

NENI 2  
EMERTIMI SELIA E SHOQERISE

Shoqëria do te ushtroje veprimtarinë ne baze te këtij statuti dhe do te kete emertimin **DuaSol Green Albania** do te ushtroje aktivitetin ne republiken e shqiperise ne baze te rregjistrimit ne institucionit perkates.

Selia e shoqërisë me Përgjegjësi te Kufizuar **DuaSol Green Albania** është Rrugen “Myslym Shyri”, Pallati 43, Shkalla 1, Ap. 3, Tirane. Shoqëria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin .

NENI 3  
KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë se shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar **DuaSol Green Albania** është pa afat me vendim te asamblesë se ortakeve, kohëzgjatja e aktivitetit mund te zgjatet ose te shkurtohet, te ndërpritet tërësisht ose menjëherë.

NENI 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise **DuaSol Green Albania** eshte


- Aktivitet tregtare ne fushen e turizmit kulturor dhe ne fushen e hotelerise
- Sherbime ne promovimin e aktiviteteve turistike
- Organizim evente sociale dhe kulturore
- Sherbime te akomodimit turistik
- Agjensi turistike, organizimi i udhetimeve turistike, biznese, turne, pushime, sherbime per udhetime tokesore, ajrore e detare. Rezervime dhe pergatitje bletash. Sherbime dhe pronotime hotelesh brenda dhe jashte vendit.
- Makina me qera
- Promovimi dhe punesimi i te rinjve
- Prodhime artizanale, tregetim me pakice dhe shumice i suvenireve
- Sherbim informacioni dhe guida per turistet

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, objektin e veprimtarise se saj me Vendim te Asmblese se Ortakeve.

NENI 6  
KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë **DuaSol Green Albania** është 100,000 leke dhe i ndare ne 1 kuote me kontributin e ortakeve si me poshtë:



1. Një kuote **Z. Xhulio Mata** ne masën 100 % (njqind perqind) te kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku themelues, ai mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marrin ortaku, por asnjëherë nuk mund te pakësohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

#### NENI 7

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar per efekt vlefshmerie duhet te behet me Akt Noterial dhe te rregjistrohet si ne librin e shoqërisë ashtu dhe ne Zyren e Rregjistrimit Tregetar.

#### NENI 8

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve .

#### NENI 9

Transferimi i pajisjeve te kapitalit themltar tek te tretet, jo ortake, duhet te miratohet nga asambleja e ortakeve.

#### NENI 10

Shoqeria ka te drejte te lere peng nje pjese te kapitalit te saj themeltar .Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar pjese te kapitalit, me perjashtim te rastit kur shoqeria preferon ti bleje ato dhe te deklaroj zvogelimin emundshem te kapitalit themeltar.

#### NENI 11

##### STRUKTURA E SHOQERISE

Asambleja e ortakeve eshte Organi suprem i shoqerise. Ajo perbehet nga ortaket me te drejte vote ne mbledhjen përkatëse.

Asambleja funksionon sipas percaktimeve te bera ne kete statut dhe dispozitave ligjore ne fuqi.

#### NENI 12

Vendimet e asamblese se ortakeve ,ne perputhje me ligjin, dhe normat e ketij statuti jane te detyrueshem per te gjithë Ato regjistrohen ne librin e shoqerise.

#### NENI 13

Cdo i interesuar mund te kerkoje ne gjykate anullimin e vendimit te Asamblese se Shoqerise te mare ne kundërshtim me ligjin apo normat e ketij statuti.

#### NENI 14

Aktiviteti financiar i shoqerise kontrollohet nga Ekspertet kontabel te emeruar.

#### NENI 15

##### ASAMBLEJA E SHOQERISE VENDIMARRJA

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendim marres i shoqerise. Ajo mblidhet ne seance te zakonshme te pakten cdo nje vit.

#### NENI 16

Mbledhja e zakonshme e asamblese drejtohet me rotacion nga ortaket, ose nga personi i autorizuar prej tyre me vendim te asamblese.

#### NENI 17

Ne mbledhjen e asamblese mund te marrin pjese Administratori kur ky eshte i jashtem, pra nuk eshte ortak ne shoqeri ekspertet kontabel te autorizuar, pa te drejte vote.

#### NENI 18



Mbledhja e asamblese njoftohet me shkrim jo me pak se 15 dite perpara, ku duhet te permbaje kohen/daten/oren/ vendin dhe rendin e dites. Keto shenohen ne librin e shoqerise.

#### NENI 19

Njeri nga ortakët mund te kerkoje shtyrjen e dates se mbledhjes, por kjo nuk mund te aplikohet me shume se njehere.

#### NENI 20

Per marrjen e vendimeve ne mbledhjen e asamblese pesha e votes dhe vendimeve ne mbledhjen e asamblese pesha e votes dhe vendimeve percaktohet nga kapitali themeltar i ortakut votues apo perfaqesues te tij. Percaktues eshte vota e ortakut qe ka kapitali me shume.

#### NENI 21

Asambleja e ortakeve vendos per:

- Ndryshimin e dispozitave te statusit
- Emerimin e administratorit dhe shkarkimin e tij
- Miratimin e rregulloresse brendshme te shoqerise ose ndryshimine dispozitave te saj
- Prishjen e parakohshme te shoqerise
- Ndryshimin e kapitalit themeltar
- Vendimet qe percaktojne politiken e drejtimit te shoqerise
- Emerim apo shkarkim te administratoreve te filialeve te shoqerise
- Miratim ose mospranimin e propozimeve te administratorit per kushtet e kontrates se punes per personelin e shoqerise
- Miratimin e raportit vjetor te administrimit te shoqerise
- Miratimin e marveshjeve apo investimeve .
- Miratimin e struktures se shoqerise dhe ndryshimet e saj.

#### NENI 22

##### DREJTIM DHE ADMINISTRIM

Per drejtimin e shoqerise ortakët emerojne Administratorin. I cili mund te jete nje nga ortakët ose nje person tjetër i zgjedhur nga ortakët. Kur eshte i jashtem percaktohen dhe kushtet e punes nepermjet kontrates se punes. Administratori zgjidhet per nje periudhe 5 vjecare.

#### NENI 23

Shoqeria **DuaSol Green Albania** ka vulen e saj.

#### NENI 24

Emri i shoqerise, administratorit si dhe vula e shoqerise duhet te figurojne ne te gjitha shkresat zyrtare te shoqerise si dhe dokumenta qe kane te bejne me permbushjen e objekti, apo qe i sherbejne ushtrimit te aktivitetit te saj.

#### NENI 25

Administratori perfaqeson shoqerine ne mardhenie me te tretet, duke zbatuar politiken e drejtimit te shoqerise. Ne raste te vecanta mund edhe te caktojte nje njeri tjetër me prokure te posacme ose dhe nje prej ortakeve.

#### NENI 26

Administratori mban pergjegjesi per shkelje te ligjit ,statutit rregullores se brendeshme, para asamblese, te te treteve dhe instancave ligjore.

#### NENI 27

Ne fund te cdo viti administratori pergatit raportin vjetor te administrimit dhe ja paraqit Asamblese se ortakeve se bashku me inventaret dhe llogarite vjetore.

#### NENI 28

Administrator është **Z. Xhulio Mata** për periudhën 01.12.2024 – 01.12.2029

Administratori ka keto kompetenca:

- Perfaqeson shoqerine ne mardhenie me te tretet
- Drejton aktivitetin e shoqerise mbi baze te objektit te saj
- Punesimine personelit te shoqerise
- Percaktimin e saksioneve te kushteve te kontrates te punes per personelin
- Thirrjen e mbledhjes se zakonshme
- Hartimin e paraqitjen e raportit vjetor

#### NENI 29

Shoqeria nuk merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet apo veprime juridike te administratorit, kur keto nuk jane permbajtur objektit te veprimtarise se shoqerise, ose nuk jane ne qellim te permbushjes se objektit.

#### NENI 30

Perderisa “rezerva e domosdoshemrise” te arrije 1/10 pjese te kapitalit themeltar shoqeria eshte e detyruar te depozioje 1/20 e fitimit te realizuar.

#### NENI 31

Fitimet, pasi te jene depozituar shumat e urdheruara per rezerven e te tjera, i takojne ortakeve te shoqerise.

#### NENI 32

Bilanci vjetor duhet te paraqitet ne organet tatimore, pasi miratohet nga asambleja, brenda dates 31.03. te vitit pasardhes.

#### NENI 33

Ne rast te likujdimit te Shoqerise, caktohet likuidatori, duke qene i detyruar te njoftoje per punet e shoqerise.

#### NENI 34

##### MARREDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet dispozitave te Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise.

Te gjithë personat e punesuar ne shoqeri kane te drejte te percaktojne mardheniet e punes nepermjet Kontrates se Punes dhe Kontrates Kolektive te Punes.

#### NENI 35

Mosmarrveshjet e punes zhgjidhen nga Gjykata e Rrethit, Kur mjetet e tjera nuk japin rezultat. Shoqeria respekton rregullat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore, ndersa te punesuarit jane te detyruar qe ti pranojne e respektojne ato. Te gjithë te punesuarit jane te detyruar te ruajne sekretin e punes.

#### NENI 36

Asambleja e shoqerise percakton, perfaqesimin e shoqerise ne mardhenie me te tretet, organet gjyqesore, caktimin te avokatiti si dhe ne mardhenie me sistemin fiskal e organet e tjera shteterore.

#### NENI 37

Gjithe veprimtaria e shoqerise ne aspektin ekonomik drejtohet nga administratori i shoqerise, Pjesmarrje me shoqeri te tjera, ndryshim statusi, kapitali themelor, miratim bilanci, pranim ortake te rinj percaktohet nga Asambleja e shoqerise



NENI 38  
MBARIMI I SHOQERISE

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te asamblese se shoqerise, ne rastet e parashikuara ne ligj.

NENI 39  
LIKUJDIMI I SHOQERISE

Likujdimi i shoqerise do te behet sipas dispozitave te Legjislaciont shqiptar ne fuqi dhe ne castin e likujdimit .

Kur shoqeria kalon ne procedurene likujdimit Asambleja cakton komisionin e likujdimit te cilit i paraqet pasqyrate bilancit te likujdimit dhe shoqeria mbyll aktivitetin e saj ne momentin kur ky bilanc aprovohet

Pasuria e shoqerise, pasi shlyhen detyrimet e shoqerise i kalojne ortakeve te shoqerise, sipas kapitalit themeltar

NENI 40

Likujdimi i shoqerise vendoset me vendim te Asamblese se shoqerise i cili per te kryer veprimet qe kerkohen emerone nje likuidator me tagrate percaktuara ne ligjin 9901 dt 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" likuidatori eshte pergjegjes si ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve . Ai shperblehet ne baze te vendimit te asamblese te shoqerise

NENI 41

Likuidatori i emeruar perfaqeson shoqerine dhe nenshkruan duke vene firmen nen vulen e shoqerise. Ai duhet te perfundoje shitjet qe jane te disponueshme per llogari te shoqerise, te mara nga cdo debitor llogari te sakta ne monedhe dhe te ktheje pasurine e shoqerise ne para. Per ceshtjet e mbetura pezull vendos asambleja e shoqerise per zgjedhje ne tyre. Ne perfundim te likujdimit te shoqerise likuidatori perpilon bilancin perfundimtar dhe te nxjerr buletini perkates

NENI 42  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 9723 dt 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" si dhe cdo dispozite te Legjislacionit Shqiptar qe gjen vend ne keto marredhenie Juridike Tregtare .

NENI 43

Shoqeria fiton personalitet juridik nga dita e rregjistrimit ne QKB Tirane .

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**  
**DuaSol Green Albania**

**Z. Xhulio Mata**

Xhulio MATA  
